

URDHËR
Nr. 888, datë 2.9.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 575, DATË 25.5.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
HOLANDËS”; URDHËRIT NR. 716, DATË 10.7.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
POLONISË”; URDHËRIT NR. 152, DATË 13.2.2026, “PËR
DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
REPUBLIKËS SË ÇEKISË”**

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e:

- Urdhrit nr. 575, datë 25.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Holandës”;
- Urdhrit nr. 716, datë 10.7.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”;
- Urdhrit nr. 152, datë 13.2.2026 “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Republikës së Çekisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri